



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 05.07.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Migjen Shala (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika, e pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

Munguan: Baton Dushi (Nisma), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sokol Berisha (AAK) dhe Uran Ismaili (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së dhe pronarët e qoshqeve të Komunës së Prishtinës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Egzon Azemi, në emër të GP të LVV-së, propozoi që në rend dite të futet edhe pika "Kërkesa për anulimin e kritereve të vendimit diskriminues për shfrytëzimin e pronave publike ose qoshqeve". Lidhur me këtë tha se ky vendim nuk kalon, në çfarëdo forme do ta bllokojmë e nuk do të lejojmë që pasuria e përbashkët e qytetarëve t'iu jepet në shfrytëzim atyre që qarkullim vjetor kapin shumën 5 milionë euro. Nëse kjo do të duhej të ishte kriter, pra shuma 5 milion euro, do të ishte kriter që ndalon konkurrimin. Ata që kanë 5 milionë euro qarkullim vjetor, nuk kanë nevojë që t'i shfrytëzojnë qoshqet e qytetit.

Agim Gashi tha se edhe GP i LDK-së kërkon pezullimin e këtij procesi, dhe vlerëson se që në përgatitjet për zhvillimin e këtij procesi nuk janë konsultuar grupet e interesit që atakohen në këtë proces. Një gjë e tillë dehumanizon këtë procedurë dhe shkel të drejtat elementare të atyre që merren me këtë veprimtari. Duke pasur parasysh këtë, kërkojmë që ky proces të pezullohet deri në anulimin e atyre kritereve dhe të rishqyrtohet ky pozicion i Komunës karshi interesave të këtyre njerëzve të cilët janë prezent këtu.

Sami Boroci tha se edhe ne kemi disa vërejtje në këto kritere, andaj kisha kërkuar një interpretimin nga Zyra ligjore për të parë bazën ligjore, nëse ky proces mund të kthehet në komision edhe një herë. Çështja e kritereve duhet shikuar edhe njëherë nga ana e komisionit. Veçanërisht kërkesa e këtyre protestuesve edhe e njerëzve të tjerë që na kanë kontaktuar neve, është një qarkullim prej 5 milionë euro dhe mendoj se mund të tingëllojë si kriter diskriminues. Unë deklarohej se nuk e jap votën për anulimin e këtij vendimi, sepse anulimi i këtij vendimi do të ishte krejtësisht i gabuar.

Suzan Kika kërkoj interpretim ligjor nga Zyra ligjore, për ta kthyer prapë në komision çështjen e qoshqeve.

Hafiz Krasniqi shprehu mendimin se ky konkurs është një konkurs diskriminues, sepse u jep përparësi të jashtëzakonshme oligarkëve. Edhe qëllimi dhe rëndësia e dhënies së këtyre qoshqeve duhet të jetë për njerëz që janë të papunë ose për njerëz të cilët janë me asistencë sociale. Ky konkurs duhet të rishikohet dhe i bëj thirrje anëtarit të komisionit që të japë dorëheqje nga ky komision, sepse do të bënte edhe ai ndoshta një shkelje më të madhe sesa e ka bërë sponsori i këtij konkursi.

Migjen Shala, në emër të GP të PDK-së dhe njëherësh në cilësinë e anëtarit të komisionit për përcaktimin e kritereve për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim, tha se ne i kemi mbajtur dy seanca gjatë kësaj kohe në lidhje me këtë çështje, mirëpo kjo shuma prej 5 milionë euro nuk e di që na u ka prezantuar. Këtë kriter ne si grup nuk e përkrahim, sepse po diskriminohen rastet sociale. Si Kuvend komunal, ne kërkojmë anulimin e këtij konkursi me këto kritere dhe unë jap dorëheqje nga ky komision.

Rifat Deri paraqiti kërkesën e qytetarëve të një pjese të lagjes “Veterniku”, që shprehin shqetësimin e tyre lidhur me mungesën e ujit, duke thënë se ka më se gjashtë ditë që kësaj pjese të lagjes i mungon uji. Ai kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që atyre qytetarëve t’iu jepet një përgjigje lidhur me këtë çështje.

Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se e vetmja mundësi që e kemi është dërgimi i cisternave me ujë, por që është jo për ujë të pijshëm, por për nevoja të tjera, përndryshe kompetente është kompania rajonale “Ujësjetësi”.

Eman Rrahmani tha se si Kuvend komunal e kemi edhe një mundësi tjetër ta ndalojmë këtë proces diskriminues, që të mos na detyroni që në këtë seancë ta anulohet vendimi i vitit 2017, i cili i jep këto prona në shfrytëzim. Kërkojmë që brenda ditës të merren parasysh kërkesat e protestuesve. Kjo parregullsi u vërtetua edhe nga anëtari i komisionit, i cili deklaroi që nuk ka qenë 5 milionë euro kriteri. Ai kërkoi që ky proces të anulohet.

Halim Halimi tha se këto kritere që janë përcaktuar vërtetë janë diskriminuese, pra kërkohet prej një kategorie sociale që të ndërpresin punën me të cilën e sigurojnë kafshatën e bukës dhe t’i jepet ndonjë kompanie tjetër! Unë mendoj që qëllimi i ekzekutivit, Kryetarit, është që këto qoshqe t’u jepen Devollëve. Po ashtu, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që të anulohet vendimi i marrë në këtë Kuvend në vitin 2017 për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim, dhe në emër të grupit parlamentar të LDK-së, ju njoftoj se anëtari i komisionit nga LDK tërhiqet nga komisioni.

Leutrim Retkoceri theksoi se edhe ne si Grup parlamentar i PDK-së, e kemi trajtuar këtë shqetësim dhe mendojmë se këto kritere të dhënies me qira janë barrë që nuk mund ta përballojnë shitësit e qoshqeve. Andaj, kërkojmë sqarim nga ekzekutivi se në çfarë baze është vendosur kriteri prej 5 milionë euro qarkullim. Ne si grup parlamentar kërkojmë të pezullohet ose të shtyhet ky vendim deri në sqarimin e plotë dhe vënien e kritereve të favorshme për të gjithë shitësit apo bizneset e vogla.

Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se kriteret nuk i përcakton Kuvendi komunal, ato i përcakton komisioni, pra Kuvendi vetëm mundet me i rishqyrtuar.

Vala Peshku pyeti se cila është procedura më e mirë ligjore për të vepruar ne në këtë rast për çka ne po propozojmë edhe sa është ajo e ligjshme, që Zyra ligjore duhet me na treguar. Ne si Kuvend nuk mundemi me i pezulluar kriteret, është komisioni dhe është përgjegjësi e ndarë prej neve, andaj pyes se kush duhet me e pezulluar procesin e ankandit.

Fatos Dibra bëri të ditur se komplet procesin e ankandit komisioni ia propozon Kryetarit të Komunës për anulim.

Vlora Dumoshi, lidhur me këtë çështje kërkoi nga të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, t'i harmonizojnë kërkesat e tyre dhe të dalin me një qëndrim të përbashkët.

Ardian Olluri, drejtor, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të qoshqeve, tha se ne si komision kriterin prej 5 milionë euro e kemi vendosur me qëllim të realizimit të planit për vendosjen e qoshqeve dhe ky Kuvend e ka miratuar një plan, që ne kemi menduar se është e mundshme me u realizuar ai plan.

Fiknete Bejta tha se këtë proces ne duhet anuluar për hir të këtyre qytetarëve që i kemi këtu. Ne si asamblistë duhet mbrojtur pikërisht interesin e këtyre qytetarëve. Ajo propozoi që të anulohet ky proces dhe fakti që është paraparë si kriter 5 milionë euro qarkullim, bën që të mos trajtohen barabartë grupet e interesit.

Valbona Petrovci kërkoi sqarim nga Zyra ligjore, se në çfarë periudhe kohore duhet të realizohet kriteri për qarkullim prej 5 milionë eurosh.

Fatos Dibra tha se vetëm komisioni ka të drejtë t'i përcaktojë kriteret, pra ato nuk i përcakton Kuvendi.

Drilon Pireva u shpreh se është e rëndësishme me u realizuar ky projekt i qoshqeve, duke pasur parasysh kritikën për kriterin prej 5 milion euro dhe duke mos i rrezikua as personat të cilët janë këtu, e që po ndihen të anashkaluar. Ka mundësi të gjenden mënyra më të mira për t'i përfshirë të gjitha ato grupe të interesit dhe të realizohet ky projekt.

Agim Gashi theksoi se në konsultim e sipër me të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, u pajtuam që ta propozojmë si pikë të rendit të ditës "Propozimi për pezullimin e procesit për dhënie në shfrytëzim të qoshqeve në komunën e Prishtinës".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua propozimi që në rend të ditës të futet edhe pika "Propozimi për pezullimin e procesit për dhënie në shfrytëzim të qoshqeve në komunën e Prishtinës".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 41 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 2. Propozimi për pezullimin e procesit për dhënien në shfrytëzim të qoshqeve në Komunën e Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit;**

Faqe 4 nga 10

4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës;
5. Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje;
6. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK);
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 37 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimi për pezullimin e procesit për dhënien në shfrytëzim të qoshqeve në komunën e Prishtinës.

Agim Gashi theksoi se në pajtim me të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, propozojmë që të mos e bllokojmë procesin dhe të japim kontribut që ky proces të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme, duke ruajtur interesat e qytetarëve të komunës së Prishtinës. Andaj, propozojmë që të pezullohet procesi deri në harmonizimin e kriterëve përballuese për konkurrentët.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, 1 abstenim, u miratua Propozimi për pezullimin e procesit për dhënien në shfrytëzim të qoshqeve në komunën e Prishtinës.

Sabedin Asllani, kryetar i Shoqatës së Qoshqeve në komunën e Prishtinës, në emër të Shoqatës së Qoshqeve, gjegjësisht pronarëve të bizneseve të vogla, i falënderoi të gjithë asamblistët për përkrahjen e kërkesave të protestuesve, pronarëve të qoshqeve.

Pika e tretë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Jusuf (Shaban) Qyqallës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit lidhur me këtë pikë, duke thënë se ky plan ka kaluar në këtë Kuvend në tetor të vitit 2017, pastaj me vendimin e Qeverisë për përcaktimin e zonës me interes të veçantë, diku afër gjysma e asaj hapësire është marrë prej Qeverisë dhe gjysma tjetër ka mbetur jashtë zonës. Në këtë plan e kemi sjellë këtu në Kuvend edhe një herë që ta revidojmë planin karshi vendimit të Qeverisë.

Halim Halimi ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se pse po bëhet kaq me nguti ky revidim i këtij plani, kur ne e dimë që në shtator duhet të bëhet Harta zonale, dhe pas hartimit të Hartës zonale të bëhet revidimi i këtij plani, kështu e thotë edhe Ligji mbi planifikim hapësinor.

Vala Peshku theksoi se sipas arsytimit të këtij propozimvendimit, thuhet se ky plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të komunës së Prishtinës. Pra, nuk duket e logjishme që njëherë të bëhet Harta zonale, pastaj të bëhet revidimi i planit.

Eman Rrahmani tha se në Komitetin për Politik dhe Financa kam kërkuar që të na vijnë detajet se kur janë bërë njoftimet për diskutime publike, në cilat gazeta zyrtare dhe datën kur është bërë, për shkak se ne nuk kemi gjetur që është bërë ndonjë njoftim publik lidhur me diskutimin publik për këtë plan të hollësishëm. Meqë është obligim ligjor të bëhet një gjë e tillë, do të ishte mirë që të na jepet një përgjigje edhe që të prezantohet projekti, ndryshimet të cilat janë bërë prej zyrtareve të cilët e kanë bërë këtë pjesë. Po ashtu, kisha kërkuar të dihet se cilat janë qëllimet e atij memorandumit të lidhur mes Qeverisë dhe Komunës rreth revidimit të këtij plani. Konsideroj se ai memorandum nuk është i nevojshëm, për shkak se të dyja qeveritë, si qendrore dhe ajo lokale, mund të bashkëpunojnë, t'i kryejnë projektet pa pasur nevojë për memorandum bashkëpunimi. Do të kishte qenë mirë që të kemi edhe një informacion, për shkak se ky plan e përkufizon edhe një pjesë të projektit të Prishtinës së Re.

Fadil Gashi kërkoi nga drejtori i drejtorisë përkatëse, të tregohet saktë se kur do të kryhet Harta zonale.

Egzon Azemi u shpreh se ne nuk jemi kundër realizimit të këtij projekti, por i kemi disa shqetësime, dilema, siç janë: Çfarë kuptimi ka memorandumit i bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Komunës, kur planet janë, ligjet janë, pra mund të bashkëpunojnë edhe pa memorandum! Memorandum bashkëpunimi mundet me u bërë mes një organi jo qeveritar, po jo Qeveria me Komunën e Prishtinës. Shqetësim tjetër është se këtu shumë lehtë mund të kemi edhe konflikt interesi, për shkak se zotëri Selim Pacolli, i cili është nënkryetar i Komunës, njëkohësisht është edhe aksionar i biznesit "Mabetex", e po ashtu edhe Behgjet Pacolli, që është ministër e zv. kryeministër, gjithashtu është pronar i kësaj kompanie. Pikërisht në këtë projekt janë të ndërlidhura edhe Komuna edhe Qeveria, kështu që këto projekte pozitive për qytetarët nuk guxojnë të përfundojnë për interesa të ndryshme.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se procesi i hartimit të Hartës zonale nuk e pengon këtë plan për realizim. Ky plan ka dalë në diskutim publik, ku në hartimin e tij janë angazhuar stafi, njerëzit përgjegjës, dhe do të ishte e pakuptim të tërhiqet dhe të mos miratohet.

Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se për këtë plan është marr një vendim për fillim të hartimit dhe për lënien në diskutim publik të projektdokumentit për revidimin e planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Nol Nushi tha se sa i përket memorandumit të bashkëpunimit të lidhur mes nivelit qendror dhe Komunës, kjo qëndron, sepse komunat vazhdimisht lidhin memorandume me nivelin qendror. Linjat buxhetore janë të ndara, funksionojnë si etnitete të ndryshme, prandaj i lidhin memorandumet e bashkëpunimit.

Agim Gashi tha se që nga shtatori i vitit 2013, kur është miratuar ndryshimi i Ligjit për planifikimin hapësinor, kanë dalë këto probleme, edhe kjo qeveri tash e sa vjet nuk është në gjendje me rishikuar ose me i harmonizuar ligjet përkatëse mes veti, në mënyre që në komuna të mos ketë konteste të tilla procedurale. Unë konsideroj se problemi është te mosfunksionimi i hierarkisë shtetërore, përkatësisht ministrive, që janë kreatorë i këtyre paqartësive ligjore, ku dalin këto probleme dhe njerëzit kanë të drejtë që kontestojnë, sepse ligji është më i fuqishëm se një akt tjetër, një vendim i Kuvendit komunal.

Fiknete Bejta, sa i përket memorandumit të lidhur mes nivelit qendror dhe Komunës, konsideroj se kryeministri pas shumë vendimeve për të mirën e kryeqytetit, ka treguar vullnet që përmes këtij memorandumit të nxisë zhvillimin e projekteve, si "Prishtina e Re" në të mirë të qytetarëve të Prishtinës. Dihet që ky projekt duhet të nxisë zhvillimin infrastrukturor, duhet të ndikojë edhe në rritje ekonomike, mirëpo edhe në hapje të vendeve të reja të punës.

Sami Boroci tha se projekti i Prishtinës së Re ose zhvendosja në atë pjesë, ka qenë projekt me të cilin AKR-ja ka garuar në këto zgjidhje, të cilën e ka pas kauzë kryesore. E kemi

harmonizuar bashkë me partnerin e koalicionit, dhe më vjen mirë që e ka edhe përkrahjen e Qeverisë dhe po fillon me u jetësuar. Është zgjidhja më e mirë dhe nuk duhet kontestuar ne absolutisht këtë, sepse mendoj që veç po politizohen e po stopojmë projekte të cilat potencialisht kanë me shkarkuar qytetin, kanë me krijuar infrastrukturë të re edhe perspektivë shumë më të mirë në Prishtinë.

Lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura rreth këtij Propozimvendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje, sqarime të nevojshëm dhanë Genc Bashota, drejtor, dhe Florim Krasniqi, përfaqësues nga drejtoria përkatëse.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 5 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje.

Pika e gjashtë

Ppropozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu) pjesa jugore.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu) pjesa jugore.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit në Hajvali, Federatës së Futbollit të Kosovës.

Mirsad Vitia tha se që ta kemi më të qartë para se të votojmë këtë propozimvendim, është e udhës që të parashtrihen disa pyetje në drejtim të ekzekutivit, apo Kryetarit të Komunës.

1. Pse Federata e Futbollit e Kosovës nuk e ka drejtuar kërkesën direkt tek ju si ekzekutiv, ose tek ne si këshilltarë komunalë, ose Kryetarit të Komunës, meqë prona është komunale, pse duhet ta bëjë një gjë të tillë ministri?
2. Përveç Komunës, deri më tani a ka qenë edhe ndokush tjetër pjesëmarrës në financimin e ndërtimit të stadiumit?
3. Pse duhet që ne t'ua japim këtë stadium në shfrytëzim për 40 vjet?
4. Çfarë ka planifikuar Federata e Futbollit e Kosovës sa i përket këtij stadiumi?
5. Kur pritet të përfundojë ky stadium, meqë është premtuar kaherë?
6. A do të ketë fusha ndihmëse?
7. A janë planifikuar lokale afariste, parkingje të mjaftueshme etj.?

Megjithatë, propozoj dhe insistoj që para se të votojmë një propozim të tillë gjysmak, siç e kemi pranuar një javë më parë, duhet që patjetër të fusim një kusht thelbësorë në favor të klubit futbollistik "Hajvalia". Kërkoj që klubi futbollistik "Hajvalia" të ketë të drejtën e

shfrytëzimit të stadiumit pa kompensim, përfshirë të gjitha grup-moshat, shkollën e futbollit "Hajvalia", si dhe klubin futbollistik për femra "Hajvalia".

Sami Boroci u shpreh se meqë po realizohet ky propozimvendim, duhet t'u garantohet një e drejtë atyre klubeve, të cilat në këtë rast ndoshta nuk e di çfarë marrëveshje ka me bërë Komuna e Prishtinës me Federatën, sepse edhe unë e përkrah dhënien në shfrytëzim, mirëpo mendoj se duhet pasur parasysh që pjesë e marrëveshjes me qenë edhe një nen, që i siguron klubit të futbollit "Hajvalia" shfrytëzimin e stadiumit.

Adrian Berisha e mbështeti kërkesën e z. Vitia, që të kushtëzohet Federata e Futbollit e Kosovës për dhënien në shfrytëzim të stadiumit klubit futbollistik "Hajvalia" si për meshkuj, ashtu edhe për femra, dhe që kjo me qenë kusht në kontratën apo marrëveshjen në mes të Komunës së Prishtinës dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.

Leutrim Retkoceri u shpreh se edhe ne e përkrahim këtë pikë. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të caktohen me kontratë, ku besoj se kjo kontratë do të jetë në harmonizim me ligjet dhe rregulloret aktuale të Komunës së Prishtinës. Sa i përket asaj që u çekën nga parafolësit për kushtëzime, mendoj se është një logjikë e mbrapsht, nuk mendoj që duhet me përfaqësuar atë logjikë.

Osaman Bllaca tha se Federata e Futbollit e Kosovës, gjegjësisht në koordinim normal me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kanë bërë kërkesë te Shtëpia e Futbollit të Evropës UEFA për me ndihmuar Kosovën në infrastrukturën sportive, përkatësisht të futbollit. Kërkesa e tyre ka qenë që me iu dhënë në shfrytëzim për më shumë se 40 vjet stadiumin e futbollit "Hajvalia", me qëllim që investimin ta bëj direkt UEFA. Ky stadium ka me qenë i kapacitetit diku më tepër se 16.000 ulëse. Do të jenë edhe fushat sintetike, do të ketë fusha ndihmese. Do të ishte e pakuptimtë për me e kushtëzuar UEFA-në.

Arbenita Murseli, sa i përket këtij propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të Hajvalisë Federatës së Futbollit të Kosovës, mendoj që është më e mira që mund t'i ndodhë një stadiumi, i cili që një kohë të gjatë është lënë në hije, edhe pse një shumë e madhe e parave është destinuar për të. Kjo do të ishte edhe një motiv për klubet e futbollit të Hajvalisë, pra që ky sa më shpejt t'i kthehet rinisë së kësaj lagjeje.

Vala Peshku theksoi se qëllimi për dhënien në shfrytëzim të pronës sipas këtij propozimvendimi, shumë qartë është e përshkruar në nenin 3, ku thuhet se: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës të cekura në pikën 2 të këtij propozimi, është ndërtimi i stadiumit, përkrahja dhe avancimi i sportit në Kosovë dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive për shfrytëzuesit e stadiumit Hajvalia.

Eman Rrahmani e përkrahu propozimin e z. Vitia dhe shtoi se këtij propozimvendimi duhet t'i shtohet edhe pjesa ku Federata obligohet t'i japë në shfrytëzim pa pagesë këtij klubit, do të thotë të ketë një garanci, që në të ardhmen Federata nuk do ta penalizojë klubin futbollistik "Hajvalia".

Nol Nushi u shpreh se përderisa është investim i UEFA-së, nuk mundemi me shkuar me kësi propozime të kushtëzimeve. Pra, shfrytëzimi i stadiumit nuk është shpenzimi kryesor i një klubi futbollit, ato zgjidhen me subvencione nga Komuna, klubet komunale aplikojnë në Komunë, marrin subvencione me projekte. Njëri prej zërave të projekteve mundet me qenë pagesa e stadiumit, nëse shihet si e nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 vota për, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të Stadiumit të Futbollit në Hajvali, Federatës së Futbollit të Kosovës.

**Pika e tetë
Pyetje dhe përgjigje.**

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Hapësinorë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

1. A është përfshirë në Planin rregullativ dhe zhvillim urban lagjja "Emshiri", ngase ajo lagje është pothuajse e zhytur në kolaps total, pasi që problemi me ujërat e zeza është evident? Po ashtu trafiku është i stërngarkuar, pasi që qasja në qytet është me vetëm një kyçje tek rreth-rrrotullimi, ku shkaktohet kaos total në komunikacion përgjatë tërë ditës;
2. Siç dihet, amfiteatri tek sheshi "Zahir Pajaziti", mbahen shumë aktivitete kulturore e sportive, nëse dëshiron të futësh objekte të rënda, është e pamundur, sepse aty nuk futet dot makina, prandaj është më se e nevojshme krijimi i një hapësire për tu futur brenda, për çka nevojitet një ndërhyrje. Për këtë çështje në të kaluarën është dashtë të mendohet, si shembull, në organizimin e 22-23 qershorit të 3x3 turnirit të basketbollit, kishte probleme që ta fusnin koshin e basketbollit. A do të ndërmerren masa për këtë shqetësim?
3. Rruga "Edmond Hoxha" tek Kacallarët, gjithashtu është tejet e ngarkuar me komunikacion dhe kolaps urban. A do të merren masa, duke e përfshirë në Plan rregullues edhe këtë rrugë tejet të rëndësishme të lagjes dhe qytetit tonë?
4. Në lagjen "Qafa", restorant "Gresa" ka hapur disa dritare të kuzhinës së saj, me ç'rast ka shkaktuar erëra, të cilat po kundërmojnë, e që ka ngjallur reagimin e qytetarëve të banesave kolektive në këtë pjesë (2 hyrjeve), ngase detyrohen t'i mbyllin dritaret dhe dyert nga kundërmimi. Kërkoj që Drejtoria e Inspeksionit, bashkë me banorët dhe drejtuesit e restorantit ta gjejnë zgjidhjen adekuate për këtë shqetësim-problem.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kulëta**

Faqe 10 nga 10